

20180991841

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PUNËSIM TË PERSONAVE INVALIDË

Neni 1

Në Ligjin për punësim të personave invalidë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/11, 129/15 147/15 dhe 27/16), në nenin 1 fjalët: "tregtar individ" zëvendësohen me fjalët: "person i vetëpunësuar".

Neni 2

Në nenin 2 pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

"Personit invalid me moshë mbi 26 vjet, i cili ka dokument për llojin dhe shkallën e pengesës sipas rregullave ligjore të mbrojtjes sociale të lëshuar para më shumë se 10 vitesh, gjatë punësimit të parë detyrimisht i përcaktohet invaliditeti nga komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë të Fondit."

Neni 3

Në nenin 8 fjalët: "tregtar individ" zëvendësohen me fjalët: "person i vetëpunësuar".

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Person i vetëpunësuar konsiderohet personi fizik i cili në mënyrë të mëvetëshme kryen veprimtari ekonomike ose profesionale dhe shërbim tjetër intelektual nga i cili realizon të ardhura, në pajtim me ligjin".

Neni 4

Në nenin 16 në paragrafin 1 fjalët: "tregtar - individ" zëvendësohen me fjalët: "person i vetëpunësuar".

Pas paragrafit 3 shtohet paragraf i ri 4, si vijon:

"Aktvendimi nga paragrafi 3 i këtij neni miratohet pas këqyrjes së kryer paraprake nga Qendra për punësim dhe Këshilli drejtues i Agjencisë për përmbushjen e kushteve për ndarje të mjeteve nga Fondi i veçantë."

Paragrafët 4, 5, 6 dhe 7 bëhen paragrafë 5, 6, 7 dhe 8.

Në nenin 8 i cili bëhet paragraf 9 fjalët: "tregtar individ" zëvendësohen me fjalët: "person i vetëpunësuar".

Neni 5

Në nenin 16-a paragrafi 1 në pikën 3) në fjalinë e parë fjalët: "dhe dorëzon hipotekë në proporcion 2:1 ose garanci bankare në lartësi të mjeteve të miratuara" dhe fjalia e dytë shlyhen.

Pas pikës 3 shtohet pika e re 4, si vijon:

"4) asistent i punës i personit invalid i cili është përfshirë në aftësimin për punë, me kërkesë të tij apo me kërkesë të punëdhënësit."

Pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3, si vijon:

"Parashtruesi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për dedikimet nga paragrafi 1 pika 3) e këtij neni, në kushtet e përcaktuara në Ligj, nëse është afarist aktiv së paku tre vjet, ka bonitet pozitiv që dëshmohet me dokument të lëshuar nga institucioni kompetent, paguan rregullisht rrogë dhe kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me ligjin për nëntë muajt e fundit, dorëzon garanci bankare në shumën e mjeteve të miratuara që i kërkon nga Fondi i veçantë me vlefshmëri prej së paku tre vjet dhe nuk është në lidhje pronësore, organizative ose drejtuese me subjektin juridik nga i cili furnizohet me pajisjen."

Paragrafi 3 bëhet paragraf 4.

Paragrafi 4 i cili bëhet paragraf 5 ndryshohet si vijon:

"Parashtruesi i kërkesës mund të shfrytëzojë mjete nga Fondi i veçantë për dedikimet nga paragrafi 1 pika 1) e këtij neni në kushtet e përcaktuara në Ligjin, nëse është afarist aktiv, ka bonitet pozitiv që dëshmohet me dokument të lëshuar nga institucioni kompetent dhe paguan rregullisht rrogë për nëntë muajt e fundit llogaritur nga dita e punësimit të personave invalidë dhe dorëzon garanci bankare me afat të arritjes deri në 11 muaj në lartësi të mjeteve që i kërkon nga Fondi i veçantë për punësim të personave invalidë. Garancia bankare do të aktivizohet nëse punëdhënësi e zvogëlon numrin e përgjithshëm të personave invalidë nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji për punësimin e të cilëve shfrytëzohen mjete nga Fondi i veçantë ose nuk u paguan rrogë dhe kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social në pajtim me ligjin."

Paragrafi 5 shlyhet.

Pas paragrafit 7 shtohet paragraf i ri 8, si vijon:

"Kushti për pagesë të rrogës nga paragrafët 3 dhe 5 të këtij neni, nuk ka të bëjë me person të vetëpunësuar."

Pas paragrafit 8 shtohen dy paragrafë të rinj 9 dhe 10, si vijojnë:

"Mjetet për asistentin e punës nga paragrafi 1 pika 4) të këtij neni, sigurohen nga Fondi i veçantë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale më afërsisht i përcakton kushtet dhe mënyrën për sigurimin e asistentit të punës dhe kompensimin financiar të asistentit të punës."

Neni 6

Në nenin 16-b pas paragrafit 6 shtohen dy paragrafë të rinj 7 dhe 8, si vijojnë:

"Nëse punëdhënësi të cilit i janë ndarë mjete të pakthyeshme për pajisjen nga neni 16-a paragrafi 1 pika 3) e këtij ligji, e zvogëlon numrin e personave të punësuar invalidë sipas të cilit janë ndarë mjete, është i detyruar që në afat prej tetë ditësh nga dita e ndryshimit të krijuar ta njoftojë Agjencinë dhe në afat prej tre muajsh ta plotësojë numrin e personave të punësuar invalidë.

Nëse punëdhënësi nuk e plotëson numrin e personave të punësuar invalidë deri në numrin sipas të cilit i janë ndarë mjete të pakthyeshme për pajisje, është i detyruar t'i kthejë mjetet e pranuar në afat prej 30 ditësh nga dita pas skadimit të afatit për plotësimin e numrit të personave të punësuar invalidë nga paragrafi 7 i këtij neni."

Paragrafët 7 dhe 8 bëhen paragrafë 9 dhe 10.

Neni 7

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Agjencia kryen këqyrje në shfrytëzimin me dedikim të mjeteve të ndara nga Fondi i veçantë në pajtim me këtë ligj.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale e përcakton më afërsisht mënyrën e kryerjes së këqyrjes së shfrytëzimit me dedikim të mjeteve të ndarë nga Fondi i veçantë.

Nëse gjatë këqyrjes konstatohet se shfrytëzuesi i mjeteve nuk i përmbush detyrimet në pajtim me dispozitat e këtij ligji, qendra e punësimit të Shërbimi qendror i Agjencisë dorëzon njoftim për parregullsitë e konstatuara.

Këshilli drejtues i Agjencisë në bazë të parregullsive të konstatuara miraton aktvendim për kthimin e mjeteve të ndara, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit nga paragrafi 3 i këtij neni.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 4 i këtij neni shfrytëzuesi i mjeteve ka të drejtë të ankesës në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Nëse shfrytëzuesi nuk i kthen mjetet e ndara në afat prej tetë ditësh nga plotfuqishmëria e aktvendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, Agjencia fillon procedurë për aktivizimin e garancisë bankare, përkatësisht dorëzon kërkesë për aktivizimin e garancisë bankare në bankën e cila e ka lëshuar garancinë bankare.

Agjencia është e detyruar të dorëzojë raporte tremujore në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për kërkesat e parashtruara për ndarjen e mjeteve nga Fondi i veçantë, si dhe për parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 4 i këtij neni."

Neni 8

Në nenin 19 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Mënyrën e realizimit të mbikëqyrjes nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale."

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

Neni 9

Në nenin 22 në paragrafin 3 dhe 4 fjalët: "tregtar - individ" zëvendësohen me fjalët: "personi i vetëpunësuar".

Neni 10

Në nenin 24 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'u shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Këshillit drejtues të Agjencisë nëse nuk veprojnë në pajtim me nenin 18 paragrafi 4 i këtij ligji."

Neni 11

Në nenin 24–b fjalët: "tregtar individ" zëvendësohen me fjalët: "personi i vetëpunësuar".

Neni 12

Aktet nënligjore miratimi i të cilave është përcaktuar me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 13

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për punësim të personave invalidë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/2000, 16/2004, 62/2005, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/11, 129/15 147/15 dhe 27/16).

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".